



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
INSTITUTI I STUDIMEVE EVROPIANE



Rruga e "Elbasanit", Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë", Kati i parë, Tiranë;

Lënda: Për kriteret e pranimit në programet e studimit të IAL-ve për vitin akademik 2025-2026

Drejtuar: REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS
Z. Artan Hoxha .

A. Kriteri bazë i përzgjedhjes për shpalljen e fituesve:

- Mesatarja e përgjithshme e studimeve Bachelor ose atij 4 vjecar të jetë 6 e lart

B. Politika e përzgjedhjes bazohet në përparësitë e mëposhtme:

Së pari: përparësi kanë aplikantët e diplomuar në Fakultet e Universitetit të Tiranës:

- a. Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë
- b. Fakulteti i Drejtësisë
- c. Fakulteti i Ekonomisë
- d. Fakulteti i Shkencave Sociale
- e. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Aplikantët e diplomuar në Universitet e Huaja sipas fakulteteve të më sipërme

Aplikantët e diplomuar në Universitet Private, të akredituar, me të njëtin profil.

C. Kush mund të aplikojë?

Për Mastër i Shkencave në drejtimin:

- **Legjislacion dhe Institucione në BE**

- Përparësi kanë aplikantët që kanë mbaruar studimet universitare në Fakultetin e Drejtësisë, UT të cilët kanë të paktën një diplomë Bachelor ose 4 vjecar, si edhe aplikantë që vijnë nga fakultete të tjera publike dhe jo publike me të njëtin profil, të huaja ose vendase pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores së fakultetit dhe VKM në fuqi.

- **Politika dhe Qeverisja në Evropë**

- Përparësi kanë aplikantët që kanë mbaruar studimet Bachelor ose 4 vjecar në UT në Fakultet e sipërcituara të UT (sipas pikës B), në Shkencat Sociale, Shkencat Politike, Drejtësi, Ekonomik, apo në fakultete të tjera publike dhe jo publike, të huaja ose vendase pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores se fakultetit dhe VKM në fuqi.
- **Diplomaci dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare të BE**
- Përparësi kanë studentët që kanë mbaruar studimet universitare në Fakultetet e sipërcituara të UT, që kanë të paktën një diplomë Bachelor ose 4 vjecar apo në fakultete të tjera publike dhe jo publike, të huaja ose vendase pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores se fakultetit dhe VKM në fuqi.

Renditja e aplikantëve do të bëhet sipas kriterëve të mësipërme duke mbajtur parasysh mesataren zbritëse nga më e larta tek më e ulta.

Kandidati nuk mund të ndjekë një kohësisht dy programe studimi IAL

Në zbatim të Udhëzimit nr. 18. Dt. 16.08. 2017 kreu IV, pika 9, në momentin e përcaktimit të datave për regjistrim në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave në ISE, kandidatët aplikantë do të paraqesin në sekretarinë e ISE-së dokumentacionin e mëposhtëm:

- Diplomën ose fotokopjen e saj të njehsuar me origjinalin të ciklit të parë të studimeve të përfunduara brenda ose jashtë vendit.
- Diplomën e Maturës shtetore së bashku me çertifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njehsuar me origjinalin, konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para hyrjes në fuqi të vendimit për krijimin e maturës shtetore, paraqesin Deftesën e Pjekurisë, origjinalin ose fotokopjen e saj, të njehsuar me origjinalin dhe të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA).
- Dëshmi të gjuhës së huaj sipas informacionit të publikuar në faqen zyrtare të MASR www.arsimi.gov.al.
- Formularin e aplikimit i cili do të merret në sekretarinë e ISE-së
- Fotokopje të dokumentit të identifikimit
- Dy fotografi personale.
- Curriculum Vitae
- Deklarat për verifikimin e dokumentacionit shkollor me të cilën do të njihen nga sekretaria e ISE-së.

Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:

Dëshmi të njohjes se gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokumet nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin

Drejtor
Prof.Dr. Aljula Jubani



**REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
INSTITUTI I STUDIMEVE EVROPIANE**



Rruga e "Elbasanit", Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë", Kati i parë, Tiranë; Tel/Fax +355 4 2 378 5353

Lënda: Për kriteret e pranimit në programet e studimit të IAL-ve për vitin akademik 2025-2026

**Drejtuar: REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS
Z. Artan Hoxha .**

Instituti i Studimeve Evropiane, Universiteti i Tiranës

Master Ekzekutiv 1-vjeçar, viti akademik 2025-2026

"EU Membership and Accession Negotiations"

Kriteret e pranimit:

Për t'u pranuar në programin e studimit të ciklit të tretë Master Ekzekutiv në "Negociatat dhe

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian" studenti/ja duhet:

1. Të zotërojë diplomën "Master i shkencave", ose një diplomë tjetër ekuivalente me të (si diplomë e nivelit të dytë, diplomë e integruar e nivelit të dytë ose një diplomë sipas sistemit të vjetër).
2. Të ketë përfunduar studimet e larta në Studime Evropiane, Drejtësi, Ekonomi, Shkenca Sociale, etj., ose të jetë i/e angazhuar profesionalisht në pozicione ku kërkohet ekspertizë në fushën e procesit të integrimit evropian.
3. Të zotërojë gjuhën angleze, duke e vërtetuar me dëshminë përkatëse Nëse individ i ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në anglisht, diploma e fituar shërben si dëshmi

për plotësimin e këtij kriteri.

4. Të dorëzojë aplikimin dhe dosjen e plotë të dokumentacionit brenda datës 6 Tetor 2025.

Dosja e aplikimit

- a) Formulari i aplikimit, që ndodhet edhe në formë elektronike në webin e ISE-së;
- b) Kopjen e noterizuar të diplomës Bachelor dhe diplomën e nivelit Master Shkencor;
- c) Jetëshkrimi i kandidatit (CV);
- d) Letër interesi ku paraqiten arsyet e aplikimit dhe lidhjen e masterit me angazhimin profesional;
- e) Një projekt-ide në lidhje me fushat me interes për kërkim shkencor të aplikantit dhe fushat/kapitujt negociues ku ka interes specifik;
- f) Dy letra rekomandimi nga persona që njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;
- g) Nëse ka, publikime apo pjesëmarrje në konferenca, që lidhen me fushën;
- h) Dokumentacionin në lidhje me vërtetimin e njohurive të Anglishtes, sipas kriterëve.

Pranimi i aplikimeve përfundon në datë 6 Tetor 2025. Aplikimi dorëzohet i firmosur dhe protokollohet në sekretarinë e programit të Masterit Ekzekutiv, pranë Institutit të Studimeve

Europiane. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet sipas kriterëve të parashikuara dhe bazohet në parimet e barazisë, të drejtësisë, të paanësisë dhe të meritës. Shqyrtimi i aplikimeve bëhet nga një Komision i posaçëm dhe kandidatët informohen për rezultatin brenda 1 jave nga mbyllja e afatit të aplikimit.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën info@ise.edu

Rruga e Elbasanit, 2, Tiranë, Albania; www.ise.edu.al

Drejtör
Prof.Dr. Aljula Jubani